

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit E. G., nga Prizreni, për shkak të veprës penale pranimi e mallrave të vjedhura nga neni 345 par.2 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.428/2015 të datës 06.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë fillestar në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, dhe të akuzuarit, me datë 17.12.2015 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E. G., nga i ati H., dhe nëna Sh. e lindur H., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën ..., nr..., ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se në muajin qershor të vitit 2014, në Prizren, në lokalitetin e tij, biznes afarist DPT “Q.”, që shërben për servisim dhe shitje të telefonave, blen sendin për të cilin ka mund të ketë ditur se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nga një qift i shtyer në moshë e b len një telefon të markës “Samsung Galasy SIII” në vlerë prej 349 Euro-sh, edhe pse ka mundur të ketë ditur që i njëjti është i vjedhur,

Këso dore ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 par.2 të KP-ës.

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajëve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.428/2015 të datës 06.03.2015, kundër të akuzuarit E. G., nga Prizreni, për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 par.2 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Musli Gashi, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.428/2015 të datës 06.03.2015, kundër të akuzuarit E. G., për shkak të veprës penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 345 par.2 të KP-së , dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethana cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

I akuzuari E. G., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale cila më vihet në barë, unë punoj si tregtar dhe kam dyqanin tim të mobi shopit, ku ushtroj veprimtarin me shitjen, blerjen dhe riparimin e telefonave mobil, me këtë profesion e siguroj ekzistencën e familjes sime. Diku në muajin qershor të vitit të kaluar, në lokalin tim i cili gjendet në bazhdarhane, ka ardhur një çift i shtyer në moshë, dhe më kanë ofruar një telefon të markës “Samsung Galaxy SIII”, dhe ate në vlerë prej 349 Euro. Duke i parë qiftin e shtyer në moshë, unë ju kam besuar që telefoni i cekur është i tyre, dhe arsyetimi i të njëjtëve ka qenë që kanë nevojë për të holla për shërim, andaj edhe kjo ka qenë arsyeja sipas tyre që e kanë shitur. Në momentin e blerjes nga ana ime, unë i kam shikuar edhe letërnjoftimin e qiftit dhe i kam besuar, dhe të njëjtin pas blerjes ja kam shitur një klienti, nuk e di pas sa kohe. Pas një kohe, pas shitjes, ka ardhur personi të cilin unë ja kam shitur telefonin paraprakisht të blerë, dhe më ka njoftuar që i njëjti është dal me pronar një person krejt tjetër. Theksoj që unë nuk e kam ditur, dhe nuk kam mundur ta dijë që i njëjti ka qenë i dikujt tjetër. Unë vetëm e kam bërë një blerje, dhe të kisha ditur që telefoni të cilin e kam blerë unë nuk është i personave që më kanë shitur, nuk do ta kisha blerë. Andaj, i propozoj gjykatës që të cekurat më lart ti ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, e po ashtu edhe faktin që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, dhe me profesionin e shitësit mundohem të siguroj ekzistencën e familjes sime. Kjo është hera e parë që bie në konflikt me ligjin, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem shumë më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla. Të gjitha këto konsideroj gjykata duhet ti merr parasysh si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin., e po ashtu edhe faktin që unë pas njoftimit nga zyrtarët policor për veprën e cila më vihet në barë telefonin e cekur e kam kthyer në polici, ndërsa blerësit i cili e ka blerë telefonin nga unë ja kam kthyer të hollat.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se në muajin qershor të vitit 2014, në Prizren, i akuzuari, në lokalin e tij, biznes afarist DPT “Q.”, që shërben për servisim dhe shitje të telefonave, blen sendin për të cilin ka mund të ketë ditur se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nga një qift i shtyer në moshë e b len një telefon të markës “Samsung Galasy SIII” në vlerë prej 349 Euro-sh, edhe pse ka mundur të ketë ditur që i njëjti është i vjedhur,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekzistonte ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 345 par.2 të KP-së, paraprakisht duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimitin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, është person familjar, baba i tre fëmijëve, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënim i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.415/2015 të datës 17.12.2015

Procesmbajtësja
Naxhis Sharani

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.